



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 508/ Prot.

Pogradec, më 08 . 02 .2021

**VENDIM**

NR. 11 , DATË 05 . 02 .2021

**“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË POGRADEC, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR, PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE Z.BEQIR XHUKELLARI, PËR SHKAK TË DËMTIMIT TË BANESËS, NGA RËNIA E ZJARRIT”**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, të pikës 1 të nenit 29, të ligjit nr. 139/2015, “Për Veteqeverisjen Vendore”, të neneve 4, 7 dhe 41, të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe të kapitullit III të V.K.M nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerezore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë:

**VENDOSI :**

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Pogradec për mbështetje financiare të shtetasit Beqir Xhukellari. dëmtimin e banesës së tij nga rënia e zjarrit në datën 18.01.2021
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Pogradec.
3. Ti akordojë familjes së shtetasit Beqir Xhukellari, ndihmën emergjente në vlerën prej **1069736lek** nga buxheti i Bashkisë Pogradec, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec për vitin 2021.
4. Ndhima financiare që do të akordohet, do të përdoret për ti ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Beqir Xhukellari banesa e të cilit është demtuar nga rënia e zjarrit.



5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Emergjencave Civile, Strehimi dhe objekteve në Bashkëpronësi, si dhe Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare, të Bashkisë Pogradec
6. Ky vendim hyn në fuqi në datën e njoftimit të subjektit.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Sotirag MANGËRI**

